

UDHEZIM
Nr. 923, date 26.12.2006

**" PER NDRYSHIME DHE SHITESA NE UDHEZIMIN NR. 106, DATE 01.07.2003 TE
ISH MINISTRISE SE EKONOMISE PER ZBATIMIN E VKM NR. 230, DATE 04.04.1998
"PER PRIVATIZIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT TE ZOTERUAR NGA SHTETI NE
SHOQERITE ME KAPITAL TE PERBASHKET"**

Ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 230, date 04.04.2003 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti ne shoqerite me kapital te perbashket" i ndryshuar me VKM nr. 777, date 11.10.2006 "Per disa shtesa dhe nr. 230, date 04.04.1998 " Ministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, me cilesine e ortakut shteteror ne shoqerite me kapital te perbashket,

Udhezon:

1. Pika 5 e Udhezimit Nr. 106, date 01.07.2003 "Per zbatimin e vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 230, date 04.04.1998 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti ne shoqerite me kapital te përbashket" riformulohet : Pas miratimit te kerkeses per privatizim, shoqeria me kerkesen e ortakut shteteror zgjedh dy eksperte, nje vleresues pasurie dhe nje ekspert kontabel te autorizuar, per vleresimin e shoqerise se perbashket per efekt te shitjes se pjeses se kapitalit te zoteruar nga shteti. Miratimi i ekspertëve behet me vendim te asamblese. Procedura e caktimit te grupit te ekspertëve dhe miratimi i raportit te tyre te behet nga Drejtoria e Administrimit te Prones Publike.

2. Pika 6 riformulohet: Shoqeria do te vleresohet ,në mënyrë01, ne perputhje me metodat bashkekohore te Standarteve Europiane te Raportimit Financiar. Kjo metode i pergjigjet realitetit dhe maksimizimit te vleres se shitjes te kuotes shteterore ne kapitalin e shoqerise dhe konsiston ne vleresimin e pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti, per efekt te shitjes me metoda bashkekohore te vleresimit te pasurise me vleren e tregut. Investigimet e ekspertëve te perqendrohen ne vleren e kontributit te pales shqiptare te vendosur ne momentin e themelimit te shoqerise; verifikimin e kapitalit te investuar ne shoqeri gjate viteve dhe progresivitetin e bilancit.

3. Pika 7 riformulohet: Trualli, si pjese perberese e kapitalit te shoqerise do te vleresohet nga grupi i ekspertëve ne kuadrin e rivleresimit te shoqerise ne perputhje me cmimin e tregut.

4. Pika 8 shfuqizohet.

5. Ne piken 11 shtesohet: VKM nr. 704 date, 11 .10.2006 "Per kriteret e vleresimit te prones shteterore qe privatizohet dhe procedura e shitjes".

6. Ne fund te pikes 12 shtohet paragrafi: Ne rast se procedura sipas pikes 5, nuk realizohet, atehere ortakut shtet cakton grupin e ekspertëve per vleresimin e shoqerise se perbashket per efekt te shitjes se pjeses se kapitalit te zoteruar nga shteti dhe mbulon shpenzimet e tyre nga llogaria e Ortakut shtet.

7. Pas pikes 17 shtohet pika 18 : Per ish pronaret e truallit te cileve u eshte njohur trualli pjese e kapitalit te shoqerise se perbashket dhe te cilet kane bere kerkese ne METE, kerkesa behet prezente

ne Agjencine e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave per t'u kompensuar ne nje nga format e kompesimit te percaktuar me ligj.

Ky Udhezim hyn ne fuqi menjehere.

MININIER I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJISË

Genc Ruli